

## 6.3 LARGIMI I SKEDAVE NGA KUJTESA E FRAGMENTEVE

Nga kujtesa e fragmenteve e regjistrimeve mund të largoni një ose disa skeda me regjistrime.



Shënim:

*Nga kujtesa e fragmenteve nuk mund të hiqet skeda me regjistrimin në redaktues.*

### 6.3.1 Largimi i skedës së përzgjedhur

Nga kujtesa e fragmenteve e regjistrimeve mund të largoni skedën e përzgjedhur me regjistrimin përkatës.

**Procedura**

1. Klikoni skedën, të cilën dëshironi ta largoni.
2. Përzgjidhni metodën **Kujtesa e fragmenteve / Largo skedën**.

**Mundësitë...**

Skedën nga kujtesa e fragmenteve e regjistrimeve mund ta largoni edhe duke përdorur metodën **Largo skedën** nga menuja e kontekstit.

### 6.3.2 Largimi i të gjitha skedave përveç asaj të përzgjedhur

Nga kujtesa e fragmenteve e regjistrimeve mund të largoni të gjitha skedat, përveç asaj të përzgjedhur.

**Procedura**

1. Klikoni skedën, të cilën **nuk** dëshironi ta largoni.
2. Përzgjidhni metodën **Kujtesa e fragmenteve / Largo skedat e tjera**.

**Mundësitë...**

Skedat e tjera mund t'i largoni nga kujtesa e fragmenteve e regjistrimeve edhe duke përzgjedhur metodën **Largo skedat e tjera** nga menuja e kontekstit.

### 6.3.3 Largimi i të gjitha skedave

Nga kujtesa e fragmenteve mund t'i largoni të gjitha skedat njëherësh.

**Procedura**

1. Përzgjidhni metodën **Kujtesa e fragmenteve / Largo të gjitha skedat**.

**Mundësitë...**

Nga kujtesa e fragmenteve e regjistrimeve mund t'i largoni të gjitha skedat edhe duke përzgjedhur metodën **Largo të gjitha skedat** nga menuja e kontekstit.